



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLOGOC

Numri i lëndës: 2022:059469

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05887955

CP.nr.235/2022

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA GLOGOC, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe sekretaren juridike Ajshe Thaqi, në lëndën përbarimore të kreditores H.P punëtore e arsimit në SHFMU “H...” në Glllogoc, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit H.K nga Glllogoci, kundër debitores Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 612.70 € duke vendosur në prapësimin e debitorit jashtë seancës gjyqësore me datë 02.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET I PA BAZUAR** prapësimi i debitorit Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit, ushtruar kundër aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.235/2022 të datës 25.05.2022, me të cilin është caktuar përbarimi i kreditores H.P punëtore e arsimit në SHFMU “H...” në Glllogoc, kundër debitores Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithëshem prej 612.70 €.
- II. AKTVENDIMI** i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc CP.nr.235/2022 i datës 25.05.2022, mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Kreditorja H.P, përmes të autorizuarit të saj H.K ka parashtruar propozim për përbarim në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc me datë 28.03.2022, kundër debitores Komuna e Glllogocit-Drejtoria e Arsimit, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Glllogoc C.nr.20/2020 i cili ka marrë formë të prerë me datë 08.02.2022, lidhur

me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në shumën prej 371.70 € dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124 €.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc me Aktvendimin CP.nr.25.05.2022 të datës 25.05.2022, ka caktuar përmbarrimin kundër debitorës.

Kundër aktvendimit për caktimin e përmbarrimit, debitorja në afatin ligjor ka ushtruar prapësim të cilin e ka kundërshtuar duke theksuar se kreditorja me rastin e parashtrimit të propozimit për përmbarrim nuk i ka bashkangjitur dokumentin përmbarrimor siç parashihet me nenin 40 par.1 të LPP-së dhe nenin 38 par.1 dhe par.2 të të njëjtit ligj e sipas të cilës propozimi për përmbarrim është dashur të hedhet poshtë.

I autorizuari i kreditorës nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të debitorës në prapësim si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale, ka vërtetuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar këto arsyeje:

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditorja, propozimin për përmbarrim e ka bërë në bazë të dokumentit përmbarruese–Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Gllogoc C.nr.205/20 të datës 19.01.2022, i cili ka marrë farmë të prerë me datë 08.02.2022 për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarrimit të parapare me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga ai aktgjykim si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarrimi, se çka përmban dokumenti i përmbarrimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarrim, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit përmbarrues janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të nenit 21, 22, 23, 24, 27 dhe nenit 38 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në nenin 71 të LPP-së, e në këtë çështje kemi të bëjmë me aktgjykimin e formës së prerë i cili i plotëson kushtet ligjore nga neni 24 i LPP-së për tu trajtuar dokument përmbarrimor.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh kundërshtimet e debitorës se propozimi nuk ka pasur të bashkangjitur dokumentin përmbarrimor por gjykata i konsideron si të pa qëndrueshme sepse kreditorja i ka bashkangjitur propozimit për përmbarrim aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc C.nr.205/2020 të datës 19.01.2022, të cilin aktgjykim debitorja e ka pranuar edhe në procedurën kontestimore por nuk ka ushtruar ankesë dhe i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 08.02.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes në propozimin për përmbarrim pasi që ka marrë aktvendimin për caktimin e përmbarrimit i ka dorëzuar debitorës një kopje të tij bashkë me aktgjykimin e lartcekur të cilën e ka pranuar me datë 01.07.2022.

Nga të cekurat si më lartë e duke u bazuar në nenin 73 parag.3 të LPP-së, gjykata ka marrë aktvendim dhe ka vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
CP.nr. 235/2024 i datës 02.07.2024.

Gj y q t a r i
Jeton Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit e përmes kësaj Gjykate.